

E DREJTA PËR INFORMIM

Së bashku për transparencën e autoriteteve publike



Me ftesë të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zhvillua një takim me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe medias investigative. Aktiviteti kishte për qëllim të bënte një bilanc të veprimitarisë së zhvilluar në këtë fushë përgjatë vitit 2023, risitë e ndryshimeve në legjislacionin për të drejtën e informimit, si dhe shtimin e përpjekjeve për konsolidimin e kulturës së përgjegjshmërisë e të transparencës së autoriteteve publike.

Komisioneri, z. Besnik Dervishi, theksoi në fjalën e tij se “Komunikimi i vazhdueshëm me OjF, subjektet e medias investigative apo grupet e interesit është një praktikë e konsoliduar pune për institucionin. Ne kemi një mision të përbashkët dhe arritja e objektivave duhet të bazohet mbi frymën e bashkëpunimit dhe mirëbesimit të të gjithë faktorëve që kontribuojnë për t’i bërë më transparente autoritetet publike shqiptare.”

Zyra e Komisionerit prezantoi ndryshimet dhe përmirësimet në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, që kanë hyrë në fuqi në fillim të muajit nëntor 2023, proces ky i konsultuar gjerësisht me shoqërinë civile, organizatat e medias investigative dhe grupet e interesit. Këto risi kanë përmirësuar akoma edhe më shumë standardet dhe praktikat kombëtare në këtë fushë, duke i sjellë ato gjithnjë e më pranë atyre më bashkëkohore evropiane e ndërkombëtare. Ndër përmirësimet kryesore të legjislacionit janë ato mbi konsolidimin e kompetencave të institucionit; detyrimin e autoritetit publik për zbatimin e vendimmarrjes së Komisionerit; përcaktimin e përgjegjësive të çdo nëpunësi për mospërbushjen e dispozitave të kuadrit ligjor të kësaj fushe; forcimin e rolit të koordinatorit brenda strukturës së autoritetit publik; mbi përditësimin periodik të Programit të Transparencës dhe Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve, apo rishikimin me ulje të kufijve të poshtëm të sanksioneve administrative për mospërbushjen e detyrimeve ligjore që kanë vendosur një raport më të drejtë dhe proporcional me të ardhurat në administratë.

Të pranishmit vlerësuan punën dhe qasjen e Zyrës së Komisionerit dhe trajtuan çështje e problematika konkrete që janë të ndjeshme në veprimitarinë e tyre. Nga ana tjetër, u diskutua për shfrytëzimin e të gjitha mundësive për të ndikuar në rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimit të autoriteteve publike në përbushjen e detyrimeve për ushtrimin plotë të të drejtës për informim.

Vendimmarrja e Zyrës së Komisionerit

Vendim Nr. 54 - Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër

Vendim Nr. 55 - Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër

Vendim Nr. 56 - Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër

Vendim Nr. 57 - Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër

Vendim Nr. 58 - Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër

Vendim Nr. 59 - Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër

Vendim Nr. 61 - Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Vendim Nr. 62 - Bashkia Librazhd

Vendim Nr. 63 - Bashkia Fushë-Arrëz

Vendim Nr. 64 - Bashkia Këlcyrë

Vendim Nr. 65 - Agjencia e Trajtitimit të Konkencioneve

Vendim Nr. 66 - Bashkia Divjakë

Vendim Nr. 67 - Bashkia Kurbin

Vendim Nr. 68 - Bashkia Vorë

Vendim Nr. 71 - Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Vendim Nr. 72 - Bashkia Krujë

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit dhjetor 2023.



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit dhjetor 2023, ka dhënë 16 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Me vendimin nr. 55, datë 07.12.2023, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj Autoritetit Publik “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Dibër Sh.A” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni dhe konkretisht:

- *Lista e plotë të objekteve shkollore, të ciklit 9-vjeçar dhe gjimnaze si dhe qendra shëndetësore dhe ambulancë e konsultore në kompetencat tokësore të autoritetit publik, të cilat janë të lidhura me rrjetin ujësjiellës dhe ofrohet shërbimi në objekte.*
- *Lista e objekteve që nuk ofrohet shërbimi për furnizimin me ujë të rrjedhshëm si dhe analizat përkatëse se pse nuk është vendosur lidhja në rrjetin ujësjiellës.*
- *Rezultatet e plota të analizave të kryera për ujin, nga laboratorët nën varësi të UKD-së apo analiza që mund të jenë kryer si monitorim i jashtëm, në harkun kohor të gjashtë muajve të fundit për objektet shëndetësore dhe arsimore, të sipërcituara, që furnizohen me ujë.*

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Pas përfundimit të seancës dëgjimore Autoriteti Publik vendosi në dispozicion të ankuesit listën e plotë të objekteve shkollore të ciklit 9 – vjeçar, gjimnaz, qendra shëndetësore, ambulancë dhe konsultore si dhe një kopje të rezultateve të analizave për ujin e pijshëm të kryer nga laboratorët e njësisë në varësi të autoritetit publik.

Në vijim, ankuesi konstatoi se ndërkohë që pika e parë dhe e dytë e kërkesës ishte vendosur në dispozicion, për sa i përket pikës së tretë ishin vendosur të dhëna vetëm për Bulqizën. Në këto kushte, ankuesi, vijoi me ankimin në lidhje me pjesën e mbetur të pikës tre të kërkesës për informacion.

Për sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstatoi se Autoriteti Publik, ka përmbushur detyrimin në lidhje me dy pikat e para të kërkesës për informacion dhe pjesërisht për pikën tre të kërkesës.

Komisioneri konstatoi se Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion një kopje të analizave të kryera për ujin e pijshëm për objektet në varësi që i përkasin territorit të Bashkisë Bulqizë, pa përfshirë informacion/dokumentacion për objektet në territorin e Bashkisë Dibër, Bashkisë Klos dhe Bashkisë Mat.

Nga verifikimi i kryer nga ana e Zyrës së Komisionerit në Ekstraktin e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, rezultoi se, autoriteti publik është shoqëri aksionere, me pjesëmarrje të aksioneve 51 % Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, 18.80 % Bashkia Dibër, Bashkia Bulqizë 12.18 %, 4.16 % Bashkia Klos dhe 13.86 % Bashkia Mat.

Pra, nga sa më sipër, rezultoi se autoriteti publik është një shoqëri tregëtare me aksione publike, që ushtron funksione publike, me objekt të veprimtarisë së saj përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve dhe për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e LDI.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kërkesa për informacion konsiston në vënien në dispozicion të kopjeve të analizave të ujit të pijshëm të cilat janë përpiluar apo zotërohen nga autoriteti publik në ushtrim të detyrës funksionale dhe ky informacion përbën një interes të lartë për publikun. Në këto kushte, informacioni i kërkuar në pikën 2 të kërkesës për informacion përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Bazuar në këtë dispozitë, Autoriteti Publik, duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit/ankuesit informacionin e zotëruar në lidhje me këtë kërkesë, në përputhje me nenin 17 të LDI.

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.



Zyra e Komisionerit në “Panairin Ndërkombëtar të Tiranës 2023”

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë në edicionin e 29-të të “Panairit Ndërkombëtar të Tiranës”, i cili u mbajt në mjediset e Pallatit të Kongreseve në datat 6-9 dhjetor 2023. Ky aktivitet shërbeu si një platformë informimi, komunikimi dhe nxitje e bashkëpunimit mes qytetarëve, institucioneve publike/shtetërore dhe komunitetit të biznesit, për ofrimin e shërbimeve inovatore dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit.



Në kuadër të seminareve/trajnimeve të programuara si pjesë e agjendës së Panairit, Zyra e Komisionerit zhvilloi aktivitetin me temë “Siguria e të dhënave personale në Shqipëri dhe sfidat e digjitalizimit”. Në fokus ishte informimi dhe njohja me kuadrin rregullator në fuqi në këtë fushë, roli dhe veprimtaria mbikëqyrëse e institucionit dhe ecuria e procesit të përafrimit të plotë të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (GDPR) me legjislacionin kombëtar. Të ndërthurur me shembuj nga praktika, prezantimet e Zyrës së Komisionerit trajtuan edhe ndërveprimin mes zbatimit të standardeve më bashkëkohore me sfidat e transformimit teknologjik/digjital në orfrimin e shërbimeve me cilësi dhe përgjegjshmëri, si në sferën publike ashtu edhe në atë private. Të pranishmit shfaqën interes edhe mbi aspekte të tjera të rëndësishme në këtë fushë, si përmbushja e detyrimeve për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI), rolin e personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale (DPO), certifikimi dhe akreditimi, etj. Aktiviteti shërbeu, gjithashtu, si një mundësi për nxitjen e njohurive të profesionistëve të rinj dhe për shkëmbimin e ideve e tendencave në funksion të rritjes së kulturës për respektimin e kësaj të drejte e lirie themelore individuale dhe për një mjedis digjital sa më të sigurt.

Java e integritetit, forum në Fakultetin e Drejtësisë

Në kuadër të “Javës së integritetit”, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, organizuan një forum diskutimi në mjediset e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Në këtë aktivitet morën pjesë ekspertë të politikave antikorrupsion, të së drejtës për informim, si edhe studentë e staf akademik. Njëkohësisht, në takim ishin edhe përfaqësues nga Zyra Rajonale për Evropën Juglindore e UNODC (struktura kundër drogës dhe krimit), e cila jep një kontribut në mbështetjen e zbatimit të Konventës së OKB kundër korrupsionit në vendin tonë.



Të pranishmit u njohën me rolin dhe funksionet e koordinatorit kombëtar kundër korrupsionit, si dhe me kuadrin ligjor që garanton transparencën e autoriteteve publike dhe ushtrimin e të drejtës për informim nga qytetarët. Rritja e integritetit dhe përgjegjshmërisë së institucioneve nëpërmjet zbatimit të mekanizmave rregullatore të fushës nxit aksesin në informacion/dokumentacion me karakter publik dhe ndikon në mirëqeverisje. Po ashtu edhe përfaqësuesit e Zyrës së UNODC prezantuan veprimtarinë e tyre për sa i përket luftës kundër korrupsionit në rajonin e Evropës Juglindore.

Zyra e Komisionerit në projektin “Mbështetje për pjesëmarrjen, përgjeshmërinë dhe fuqizimin e shoqërisë civile”

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bashkëpunoi me disa organizata dhe media investigative në zhvillimin e projektit “Mbështetje për pjesëmarrjen, përgjeshmërinë dhe fuqizimin e shoqërisë civile”, i financuar nga Bashkimi Evropian.



Ky projekt u zhvillua gjatë muajit dhjetor 2023 në 6 takime, në qytetet e Elbasanit, Korçës, Tepelenës, Gjirokastrës, Shkodrës dhe Lezhës, ku të pranishëm ishin përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile apo grupeve të interesit dhe qytetarë. Në fokus ishte nxitja e ndërgjegjësimit dhe promovimi i të drejtës për informim/aksesit në informacionin/dokumentacionin me karakter publik, si dhe rëndësia e procesit të konsultimit publik në kuadër të kontrollit dhe pjesëmarrjes në qeverisje. Projekti shërbeu, njëkohësisht, si një mundësi për të njohur kuadrin ligjor të fushës, rolin dhe veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit, si dhe të rrugët e bashkëpunimi me palët e interesuara për nxitjen e ushtrimit në praktikë të kësaj të drejte. Gjatë aktiviteteve u shpërndanë edhe materiale/botime ndërgjegjësuere të Zyrës së Komisionerit. Për këtë projekt u bashkëpunua me “Qendrën për Ekselencë Destiny”, “Together for Life”, “Balkan Investigative Reporting Network” (BIRN) dhe “Qëndresën Qytetare”.

Të drejtat e njeriut, 75-vjetori i Deklaratës Universale të OKB

Në përkujtim të 75-vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), u zhvillua një tryezë diskutimi nën patronazhin e Prezencës në Shqipëri të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE).



Në këtë aktivitet morën pjesë më shumë se 30 përfaqësues të institucioneve të Avokatit të Popullit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe nga organizata të shoqërisë civile të cilat në fokusin e tyre të veprimtarisë kanë pikërisht promovimin e të drejtave të njeriut. Diskutimet në këtë tryezë u përqendruan në arritjet, sfidat dhe aktivitetet e ndërmarra përgjatë vitit 2023 për të çuar përpara “lirinë, barazinë dhe drejtësinë për të gjithë qytetarët”.

Gjithashtu, duke qenë se liria dhe drejtësia janë të ndërlidhura me heqjen e barrierave burokratike dhe rritjen e respektit ndaj institucioneve në tërësi, takimi ofroi një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin e shoqërisë civile për rolin e saj vendimtar për të promovuar e advokuar zbatimin e rekomandimeve të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut.

Të drejtat e njeriut në Shqipëri, Konferenca Vjetore e institucionit të Avokatit të Popullit

Me tëmë kryesore “75 vjetori i Deklaratës Universale dhe 25-vjetori i Kushtetutës së Shqipërisë: Evolucionin e të drejtave të njeriut në Shqipëri” zhvilloi punimet Konferenca Vjetore e institucionit të Avokatit të Popullit. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin përfaqësues të lartë të Kuvendit, të Qeverisë, trupit diplomatik, organizatave të shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe medias.

I ftuar në panelin e parë të kësaj Konference, “25-vjetori i Kushtetutës së Shqipërisë – Nevoja për interpretim Kushtetues dhe hapat për përmirësime legjislative”, ishte edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, i cili në fjalën e tij theksoi se “të drejtat e njeriut u japin zbatim parimeve të rëndësishme si dinjiteti, drejtësia, respekti dhe barazia.

Ato vendosin standardet se si jetojmë dhe punojmë. Rrugëtimi i të drejtave të njeriut është një proces dinamik i kushtëzuar nga një sërë faktorësh ekonomik, social, politik, zhvillim teknologjik, etj. Për të garantuar gëzimin e tyre nga ana e qytetarëve, kërkohet qasje dinamike nga ana e institucioneve që sigurojnë apo që monitorojnë zbatimin e tyre.”

Konferenca kishte në fokus vlerësimin e rrugëtimit të të drejtave të njeriut në vendin tonë, raportin me kuadrin legjislativ në fuqi dhe mundësinë e përmirësimit të tij, si dhe me sfidat dhe çështjet e të drejtave të njeriut që hasen nga qytetarët.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDIMDP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDMDP)